

Deklarata e Cilësisë së INSTAT

INSTAT është një institucion profesional i pavarur i cili prodhon statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Vizioni i INSTAT-it është që të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Statistikat përcaktohen sipas nevojave të përdoruesve, të publikuara në seri kohore, në mënyrë të përpiktë dhe të paraqitura në një formë të qartë dhe të kuptueshme. Pavarësia profesionale e INSTAT është e përcaktuar me ligj, i cili garanton që statistikat duhet të zhvillohen, të prodhohen dhe të shpërndahen në mënyrë të pavarur, veçanërisht për sa i takon zgjedhjes së teknikave, përkufizimeve, metodologjive dhe burimeve të të dhënave, kohës dhe formës së shpërndarjes, pa trysinë e grupeve politike, grupeve të interesit apo autoriteteve shtetërore.

Sistemi Kombëtar Statistikor koordinohet nga INSTAT-i për të siguruar që të gjithë prodhuesit e statistikave zyrtare përdorin standardet, konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodologjitë statistikore të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe Eurostat-i, aty ku është e mundur.

Kostot e prodhimit statistikor duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultateve dhe përfitimeve të kërkuara, se burimet duhet të jenë përdorur në mënyrë optimale dhe ngarkesa e përgjigjes të jetë minimale.

INSTAT punon në kuadër të proceseve të mirë-strukturuara dhe në koherencë me planin vjetor të punës. Treguesit e cilësisë dhe faktorët e tjerë të rëndësishëm në lidhje me procesin e prodhimit statistikor si dhe rezultatet e tij janë të përcaktuara mirë dhe kontrollohen vazhdimisht. Nëse treguesit e cilësisë nuk arrihen, kryhen ndryshime dhe përmirësime në proceset dhe procedurat e prodhimit statistikor.

Sistemi i cilësisë në INSTAT bazohet në 15 parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP) të publikuara nga Sistemi Statistikor Evropian (ESS):

1. Pavarësia profesionale
2. Mbledhja e të dhënave
3. Përshtatshmëria e burimeve
4. Angazhimi ndaj cilësisë statistikore
5. Konfidencialiteti statistikor
6. Paanshmëria dhe objektiviteti
7. Metodologji e përshtatshme
8. Procedurat e duhura statistikore
9. Ngarkesa ndaj të anketuarve
10. Raporti kosto-efektivitet
11. Rëndësia
12. Saktësia dhe Besueshmëria
13. Koha dhe Përpikëria
14. Koherenca dhe krahasueshmëria
15. E drejta e hyrjes dhe qartësia